



## PLAN VEPRIMI

*Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, dt. 26 qershor 2014*



Datë 07.07 2014

**MIRATOHET**

  
**Bujar LESKAJ**  
**KRYETAR**

## Hyrje :

Kontrolli i Lartë i Shtetit(KLSH), si Institucioni më i lartë Ekonomiko- Financiar në vend, njëherazi është agjent i Kuvendit për të siguruar miradministrimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve shtetërore, në bazë të Standardeve të INTOSAI-t, ISSAI 1, Deklarata e Limës, Neni 8 « *Marrëdhënia me Parlamentin* », të ISSAI 10 « *Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik-të bësh diferencën në jetët e qytetarëve* », dhe standardit ISSAI 21 « *Parimet dhe Praktikrat e mira të Transparencës dhe Përgjegjshmërisë* », në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, Neni 164 i saj, si dhe të Ligjit të tij organik. KLSH e zbaton këtë mision dhe detyrë madhore, duke i raportuar Kuvendit sipas përcaktimeve kushtetuese, si dhe duke zbatuar çdo rekomandim dhe orientim të Kuvendit.

Janë këto arsye që institucioni e konsideron një program të qartë pune për të, Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë « Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2013 », datë 26 qershor 2014.

Audituesit e KLSH ndihen të motivuar nga mbështetja e dhënë nga Kuvendi institucionit të tyre kushtetues në përmbushjen e misionit të tij, si dhe nga vlerësimet për auditimet e vitit 2013, për rritjen e rekomandimeve dhe kallëzimeve penale, për shtimin e transparencës institucionale, të marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerët vendas dhe ndërkombëtare, për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017.

KLSH i cilëson rekomandimet e Kuvendit për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2014 si themelore dhe objektiva strategjike të punës së tij për periudhën Korrik 2014-Maj 2015 e në periudhat e mëvonshme. Këto rekomandime përfshihen natyrshëm në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017, të përgatitur mbi drejtimit dhe planet strategjike të zhvillimit të organizatave INTOSAI (2011-2016) dhe EUROSAI(2011-2017) dhe do të zhvillohen më tej në masa dhe veprime konkrete.

KLSH ka përgatitur Planin e mëposhtëm të Veprimit (Korrik 2014-Maj 2015) për Zbatimin e Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 26 qershor 2014:

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Treguesit e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Vërejtje
1	<p><u>Angazhim maksimal në zbatimin e politikave antikorrupsion, në funksion të detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe të kërkesave të organizatave ndërkombëtare, rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Evropian, me qëllim mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë</u></p> <p>Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 5 «<i>Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit</i>», të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
1.1	Zhvillimi i metodologjisë për orientimin e auditimit bazuar në riskun për mashtrim dhe korrupsion	Departamenti i Kërkimit Shkencor	Maj 2015	Manuali i metodologjisë	Buxheti i Shtetit/IPA 2013	
1.2	Zhvillimi i trajnimeve specifike të stafit në lidhje me auditimin e mashtrimit dhe të korrupsionit	Departamenti i Kërkimit Shkencor; Drejtoria e B.Njerëzore	Tetor 2014-Maj 2015	Numri i audituesve të trajnuar dhe orët	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
1.3	Rritja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me agjencitë e angazhuara në luftën kundër korrupsionit (si Prokuroria e Shtetit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Autoriteti i Konkurrencës, etj.)	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit të cilësisë	Korrik 2014-Maj 2015	Nr. i Kallëzimeve për të cilat është nisur hetim nga Prokuroria, etj.	Buxheti i Shtetit	
1.4	Hartimi i metodologjisë për kuptimin dhe referimin në Prokurori të veprave penale që lidhen me mashtrimin dhe korrupsionin.	Departamenti i Kërkimit Shkencor; Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit të cilësisë	Mars 2015	Manuali i metodologjisë	Buxheti i Shtetit	
1.5	Thellimi i punës për evidentimin e rasteve të denoncimit të korrupsionit nga mediat, publiku si dhe të mesazheve që vijnë nga Kuvendi i Shqipërisë.	Njësia e Analizës së Riskut ; Departamentet e Auditimit	Korrik 2014-Maj 2015	Urdhër i Kryetarit për adresimin e përgjegjësisë, Lista e rasteve	Buxheti i Shtetit	

1.6	Shkëmbimi i përvojës me SAI-t homologe me përvojë në fushën e auditimit të mashtrimeve financiare.	Kryetari i KLSH, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë	Korrik 2014-Maj 2015	Nr. i vizitave të punës, takimeve dhe seminareve	Buxheti i Shtetit /SAI partner	
1.7	Formulimi i një rekomandimi për Qeverinë në lidhje me promovimin e transparencës për vendimmarrjet menaxheriale	Drejtorja Juridike dhe e Kontrollit të cilësisë ; Dep. i Kërkimit Shkencor	Janar 2015	Rekomandimi i formuluar	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
1.8	Identifikimi i dobësive të instrumenteve të përgjegjshmërisë menaxheriale në institucionet e audituara dhe pasqyrimi i tyre në raportet e auditimit	Drejtorja Juridike dhe e Kontrollit të cilësisë ; Dep. i Kërkimit Shkencor	Korrik 2014-Maj 2015	Dokumenti që identifikon dobësitë	Buxheti i Shtetit	
2	<p><u>Ndjekjen rast pas rasti të ecurisë së kallëzimeve penale, duke ridimensionuar komunikimin institucional me organet e drejtësisë dhe me institucionet e hetimit, si dhe kërkimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës</u></p> <p>Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht në Objektivin 5 «Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit», Nen-Objektivat 5.3, 5.4 dhe 5.8 të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH. Krahas këtyre :</p>					
2.1	Rritja e numrit të kontrolleve dhe auditimeve të KLSH për zbatimin e masave të propozuara nga institucioni për shpërblimin e dëmit ndaj Buxhetit të Shtetit	Departamentet e Auditimit	Korrik 2014-Maj 2015	Nr. i auditimeve dhe kontrolleve	Buxheti i Shtetit	
2.2	Kërkesa për hartimin e një ligji për përgjegjësinë materiale të zyrtarëve publikë në lidhje me vendimmarrjet e tyre, me qëllim parandalimin dhe kufizimin e gabimeve të rënda dhe abuzimeve në menaxhimin e fondeve buxhetore, nga ana e drejtuesve të lartë publikë	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike	Janar-Mars 2015	Dokumenti për avantazhet e ligjit, takimet dhe konsultat e organizuara	Buxheti i Shtetit	Realizimi varet nga Kuvendi

2.3	Realizimi i një memorandumi me Qeverinë, në baze të të cilit personat e administratës qendrore që kallëzohen penalisht nga KLSH për dëm të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore, të pezullohen përkohësisht nga puna si edhe inkurajimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së për Institucionet Qendrore.	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike	Dhjetor 2014-Maj 2015	Dokumenti i memorandumit	Buxheti i Shtetit	Realizimi varet nga mirëdashja e qeverisë
2.4	Thellimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Prokurorinë dhe nxitje për dërgimin ne Gjykate, në një kohë sa më të shpejte, të rasteve flagrante të denoncuar dhe të kallëzuara penalisht nga KLSH	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë	Dhjetor 2014-Maj 2015	Dokumente të bashkëpunimit	Buxheti i Shtetit	Bashkëpunimi me Prokurorinë
3	<p><u>Hartimin e programeve të punës për rritjen e efijences së veprimtarisë audituese në drejtim të auditimit të performances, auditimit financiar dhe atij tematik, si dhe rifillimin e punës për auditimin vlerësues</u></p> <p>Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht ne Objektivin 2 «<i>Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit</i>» dhe Objektivin 3 «<i>Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performances</i>» të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
3.1	Hartimi i plotë i programit vjetor të auditimit 2015 sipas modelit të bazuar në risk	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë, Dep. i Kërkimit Shkencor	Nëntor-Dhjetor 2014	Programi Vjetor i Auditimit 2015	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
3.2	Përgatitja e një udhëzuesi të veçantë lidhur me programimin e auditimit të bazuar në rrezik	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë, Dep. i Kërkimit Shkencor	Dhjetor 2014-Janar 2015	Udhëzuesi i Auditimit bazuar ne risk	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	

3.3	Trajnimi i stafit të përzgjedhur lidhur me përdorimin e modelit të riskut në programimin vjetor të auditimit	Dep. i Kërkimit Shkencor, Drejt. B. Njerëzore	Janar-Mars 2015	Numri i audituesve të trajnuar dhe orët	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
3.4	Kryerja e “Peer Review (rishikim nga kolegët)” nga një SAI i zhvilluar partner, me qëllim zbulimin e mundësive për përmirësim të mëtejshëm të performancës dhe menaxhimit të KLSH	Kryetari i KLSH, Dep. i Kërkimit Shkencor, SIGMA SAI-t partnere	Viti 2015. Nisja e procesit	Korrespondenca me SAI-n partner të përzgjedhur	Buxheti i Shtetit	
3.4.1	Kërkesë e KLSH-se për “Peer Review”, drejtuar 28 SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së	Kryetari i KLSH-së	Korrik 2014	Korrespondenca me 28 SAI	Buxheti i Shtetit	
3.5	Rishikimi i manualit të auditimit financiar	Kryetari i KLSH, Dep. i Kërkimit Shkencor, SIGMA SAI-t partnere	Procesi nis në Shkurt-Mars 2015 dhe përfundon në Maj 2015	Manuali i Përditësuar i Auditimit Financiar	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
3.6	Zhvillimi i metodologjive specifike për auditimet e performances dhe përdorimin e teknikave të reja në auditim	Dep. Auditimit të Performances, Dep. i Kërkimit Shkencor	Korrik 2014-Qershor 2015	Dokument i teknikave të reja në auditimin e performances	Buxheti i Shtetit	
3.7	Work shop për Auditimin e Performances, në lidhje me veprimtarinë audituese të Departamentit për vitin 2014	Dep. Auditimit të Performances	Nëntor 2014	Dokumente të work-shop-it	Buxheti i Shtetit	
4	<p><u>Garantimin e veprimtarisë audituese me cilësi të lartë dhe efektivitet, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit</u></p> <p>Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 «Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit» të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					

4.1	Hartimi i Strategjisë së Implementimit të standardeve të INTOSAI-t, ISSAI-ve, duke përfshirë gjetjet e “iCAT-s” (Mjetet e Vlerësimit të Pajtueshmërisë me ISSAI-t) dhe hartimin e një Plani Veprimi për implementimin e Strategjisë.	Sektori i Kërkimit Shkencor, Drejtoria Marrëdh. me Jashtë, IDI	Në vijimësi	Strategjia e implementimit	Buxheti i Shtetit	Në bashkëpunim me IDI-n
4.2	Hartimi i manualit të auditimit të Përputhshmërisë	Kryetari i KLSH, Dep. i Kërkimit Shkencor, Dep. e Auditimit	Procesi nis në Shkurt-Mars 2015 dhe përfundon në Qershor 2015	Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
4.3.	a) Zhvillimi i metodologjisë për auditimin e projekteve me fonde të BE. b) Trajnimi i stafit të përzgjedhur për këtë lloj auditimi	Dep. i Kërkimit Shkencor ,SIGMA	Tetor 2014-Mars 2015	Numri i audituesve të trajnuar, temat dhe orët	Buxheti i Shtetit / SIGMA	
4.4	Përmirësimi i skemës së menaxhimit të cilësisë së auditimit, përfshirë shqyrtimet “e nxehta” dhe “të ftohta”	Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë	Dhjetor 2014	Skema e re e menaxhimit të cilësisë	Buxheti i Shtetit	
4.5	Kontraktimi i ekspertëve të jashtëm të pavarur lidhur me vlerësimet e cilësisë së auditimit.	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë	Shtator 2014-Maj 2015	Ekspertet e kontraktuar, Raportet e tyre	Buxheti i Shtetit	
4.6	Realizimi i 13 botimeve të KLSH-së që përfshijnë tre numra të revistës shkencore “Auditimi Publik”, Standarte të Auditimit (ISSAI) , botimin për Konferencën e III Shkencore, Analizën e punës dhe performancën e institucionit për vitin	Kryetari i KLSH, Dep. i Kërkimit Shkencor	Brenda muajit Dhjetor 2014	Botimi i librave	Buxheti i Shtetit	

	2013, etj					
4.7	Rritja e prezencës së Audituesve në shtypin e shkruar me qëllim rritjen e transparencës së punës së tyre për publikun e gjerë	Departamentet e Auditimit	Shtator 2014-Maj 2015	Botimi i artikujve	Buxheti i Shtetit	
4.8	Vazhdimi i promovimit të vlerave të Institucionit dhe ngritja e komisionit për krenntimin e 95 vjetorit të tij.	Kryetari i KLSH, Drejtoria e Komunikimit dhe Shërbimeve	Janar-mars 2015	Dokumentet e aktivitetit	Buxheti i Shtetit	
5	<p><u>Konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me partneret vendas dhe të huaj, me synim përmirësimin e menaxhimit publik dhe financiar të vendit</u></p> <p>Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht në Objektivin 6 «Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit» të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
5.1	Rinisja e një bashkëpunimi konkret me strukturat e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të 8 majit 2012, mes Ministrisë së Financave dhe KLSH	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë	Shtator 2014-Maj 2015	Protokolli i Marrëveshjes së Bashkëpunimit	Buxheti i Shtetit	Në bashkëpunim e dakortësi me Ministrinë e Financave
5.2	Vazhdimi dhe thellimi i bashkëpunimit me Auditimin e Brendshëm të Ministrisë së Financave, me Autoritetin e Konkurrencës, me Institutin e Administratës Publike, si dhe me shoqatat e shoqërisë civile, me të cilët KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ne vitet 2012-2013	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë, Dep.Kërkimit Shkencor	Korrik 2014-Maj 2015	Protokollet e përditësuara të marrëveshjeve	Buxheti i Shtetit	
5.3	Vazhdimi dhe thellimi i bashkëpunimit me INTOSAI, EUROSAL, ECA dhe me SAI-t	Kryetari i KLSH, Sek. Kërkimit Shkencor, Drejtoria	Korrik 2014-Maj 2015	Protokollet e përditësuara dhe të reja të	Buxheti i Shtetit	



	partnere si SAI i Polonisë, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, ZAP-i i Kosovës, SAI i Austrisë, SAI-t e vendeve të tjera ballkanike. Lidhja e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit	e Marrëdh. me Jashtë		marrëveshjeve		
6	<p><u>Vijimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe institucionet ligj-zbatuese për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit</u></p> <p>Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht në Objektivin 1 «Zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH. Amendimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira evropiane» të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
6.1	Diskutime me Kryetarin e Kuvendit dhe me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit Kuvend-KLSH(propozime konkrete)	Kryetari i KLSH	Korrik 2014-Maj 2015	Raportime dhe informacione nga takimet e zhvilluara, aktivitete të veçanta	Buxheti i Shtetit	
6.2	Bashkëpunim në vijimësi me DG-Budget dhe SIGMA në procesin e konsultimit për miratimin e projektligjit të KLSH në Kuvend, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t, si dhe konsultime në vijimësi me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e kontrollit të cilësisë, Dep. Kërkimit Shkencor	Korrik 2014-Maj 2015	Raporte periodike mbi ecurinë e bashkëpunimit me SIGMA dhe DG Budget	Buxheti i Shtetit	
6.3	Raportime dhe prezencë e vazhdueshme në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave mbi bazën e kërkesave të Komisionit	Kryetari i KLSH	Shtator 2014-Maj 2015	Raportime dhe informacione nga takimet e zhvilluara	Buxheti i Shtetit	
6.4	Seminar pune për Standardet e INTOSAI-t dhe domosdoshmërinë e	Kryetari i KLSH Dep Kërkimit	Tetor 2014	Dokumente të Seminarit	Buxheti i Shtetit	

	qasjes së pakufizuar në informacionin për auditimin	Shkencor, SIGMA, DG-Budget				
6.5	Organizimi i Konferencës së III-të Shkencore të KLSH-së “Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes Kombëtare”	Kryetari i KLSH; Komiteti i organizimit të Konferencës	Tetor 2014	Dokumente të Konferencës	Buxheti i Shtetit	
7	<p><u>Rritjen e numrit të auditimeve të subjekteve me projekte me financim të huaj, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e shpërdorimeve të fondeve publike dhe mungesës së efektivitetit të investimeve</u></p> <p>Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 «<i>Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit</i>», Nën-Objektivi 2.3 “<i>Zhvillimi i auditimit të menaxhimit të fondeve të BE</i>”, të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
7.1	Zhvillimi i metodologjive për auditimin e projekteve me fonde të BE dhe me financime të tjera të huaja. Trajnimi i stafit të përzgjedhur për auditimin e projekteve me financim të huaj	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor	Shtator 2014-Maj 2015	Manuali ose parapërgatitjet për Manualin e Auditimit të projekteve me financime të huaja. Numri i audituesve të trajnuar, temat dhe orët	Buxheti i Shtetit	
7.2	Thellimi i bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA) në Luksemburg dhe përfshirja për herë të parë në statusin e vëzhguesit në takimin e radhës të komitetit të kontaktit në të cilin marrin pjesë 28 vendet e BE-së. Vizita studimore pranë ECA, në vende përfituese të fondeve të BE, për të ndarë eksperiencat në fushën e auditimit	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Drejt. e Marrëdh. me Jashtë, Specialistë të IPA	Korrik 2014-Maj 2015	Raporte nga vizitat e zhvilluara dhe eksperiencat e marrë	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	

8	<u>Reformimin e burimeve njerëzore për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuara nga INTOSAI, për arritjen e objektivave integruese të vendit</u>  Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 «Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit», Nën-Objektivi 2.7 “Zhvillimi i Trajnimeve Profesionale” të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH					
8.1	Hartimi i rregullave dhe procedurave për certifikimin e stafit të auditimit, në zbatim të ligjit të ri të KLSH-së. Hartimi i programit të trajnimit sipas disiplinave në lidhje me certifikimin e audituesve	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Dr. B. Njerëzore	Tetor 2014-Maj 2015	Dokumenti i rregullores së certifikimit të audituesve	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
8.2	Krijimi i Departamentit të Metodologjisë dhe Informacionit, me qëllim unifikimin e metodologjisë në auditim dhe certifikimin e audituesve të jashtëm publikë.	Kryetari i KLSH	Pas miratimit të Ligjit të ri	Udhëzime për metodologjinë e auditimit	Buxheti i Shtetit	
8.3	Përzgjedhja e trajnerëve në bashkëpunim me IEKA, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe me Shoqatën e Kontabilistëve të Certikuar dhe Audituesve të Kosovës	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Dr. B. Njerëzore	Korrik 2014-Maj 2015	Trajnerët e përzgjedhur	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
8.4	Hartimi dhe zbatimi i programit të trajnimit të vazhdueshëm në përputhje me normën e caktuar (20 ditë trajnim në vit)	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Dr. B. Njerëzore	Korrik 2014-Maj 2015	Programi i Trajnimit	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
8.5	Hartimi i strategjisë sektoriale të KLSH për rritjen e kapaciteteve audituese nëpërmjet trajnimit dhe zhvillimit profesional të audituesve	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Dr. B. Njerëzore	Tetor 2014-Shkurt 2015	Strategjia Sektoriale	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	

8.5.1	Vijimësia e realizimit të trajnimeve me SAI-et homologe (kryesisht SAI turk dhe polak)	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Dr. B. Njerëzore	Korrik 2014-Maj 2015	Programi i Trajnimit	Buxheti i Shtetit / SAI-et partnere	
8.5.2	Vijimësia e realizimit të trajnimeve me SIGMA	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Dr. B. Nj	Korrik 2014-Maj 2015	Programi i Trajnimit	Buxheti i Shtetit / SIGMA	
9	<p><u>Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivele bashkëkohore, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë</u></p> <p>Ky rekomandim është përfshirë tërësisht në Objektivin 4 «Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim» të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
9.1	Modernizimi i rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik. Krijimi i bazës së të dhënave dhe i programit të komunikimit interaktiv të asistuar	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Sekt. i Teknologjisë së Informacionit	Korrik 2014-Maj 2015. Në vijimësi	Lista e pajisjeve të blera dhe të futura në përdorim. Baza e të Dhënave. Programi i Komunikimit interaktiv	Buxheti i Shtetit /TIKA	
9.2	Insistimi për të përfshirë në Ligjin e ri të KLSH-së auditimin e TI	Kryetari i KLSH	Deri në miratimin e Ligjit	Miratimi i neneve të ligjit që lidhen me auditimin e TI	Buxheti i Shtetit	
9.3	Publikimi i standardeve Coobit 4.01. Përkthimi i Standardit ISSAI 5310 për Sigurinë e T.I. Përkthimi i Manualit për Auditimin e T.I. (të publikuar nga EUROSAT dhe INTOSAT);  Konsolidimi i strukturës së IT Audit	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Sekt. i Teknologjisë së Informacionit	Nëntor 2014-Maj 2015	Libri i Standardeve Coobit 4.01. Standardi ISSAI 5310, Manuali për Auditimin e TI	Buxheti i Shtetit /TIKA/Gjykata Turke e Llogarive	

9.4	Vazhdimi i trajnimit të stafit auditues për auditimin e teknologjisë së informacionit dhe përvetësimin e Programit IDEA. Kalimi në versionin e ri të programit IDEA.	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Sekt i Teknologjisë së Informacionit	Korrik 2014-Maj 2015	Numri i audituesve të trajnuar, temat dhe orët. Raportet nga trajnimet e zhvilluara	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
9.5	Ngritja e Njësisë për Auditimin e T.I. në nivel Drejtorie pranë një Departamenti Auditimi ose veçmas. Konsolidimi i strukturës së auditimit të T.I.	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Sekt i Teknologjisë së Informacionit	Dhjetor 2014. Përgatitje për krijimin e Njësisë	Stafi i përzgjedhur i Njësisë	Buxheti i Shtetit	
9.6	Kryerja e auditimeve pilot ne auditimin e Teknologjisë së Informacionit	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor, Sekt i Teknologjisë së Informacionit	Janar 2014-Maj 2015. Përgatitja dhe nisja e auditimeve	Raportet paraprake nga auditimet pilot	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	
10	<p><u>Strukturimin e raportit vjetor, në aspektin formal dhe të përmbajtjes, sipas përcaktimeve kushtetuese, ligjore dhe standardeve të aplikueshme nga institucionet homologe të auditimit të jashtëm</u></p> <p>Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 «<i>Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit</i>» të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH</p>					
10.1	Përgatitja e modelit të ri të raportimit vjetor në Kuvend mbi deklaratën përfundimtare buxhetore të RSH, mbi bazën e kërkesave të Ligjit të ri.	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor	Shtator 2014-Maj 2015	Modeli i raportimit	Buxheti i Shtetit /SIGMA	
10.2	Përmirësimi i vazhdueshëm i modelit të ri të raportimit për në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave si dhe në	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor	Shtator 2014-Maj 2015	Modeli i raportimit	Buxheti i Shtetit /SIGMA	

	Kuvendin e Shqipërisë, bazuar në përvojën e mirë të SAI-ve të zhvilluara evropiane					
10.3	Përcjella e vazhdueshme e informacioneve të ndryshme në trajtë inovative për Komisionin e Ekonomisë	Kryetari i KLSH, Dep. Kërkimit Shkencor	Shtator 2014-Maj 2015	Strategjia e komunikimit	Buxheti i Shtetit	

**Shenim :** *Megjithëse të dhjetë Rekomandimet e Kuvendit janë të përfshira në objektivat strategjike dhe planin e veprimit të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH, institucioni është i orientuar dhe i përkushtuar në thellimin e vëmendjes për realizimin e plotë të rekomandimeve të Kuvendit, duke përshtatur Planin e Veprimit të Strategjisë për periudhën Korrik 2014-Maj 2015 sipas kërkesave të Kuvendit.*

**Risqet në zbatimin e Planit të Veprimit:**

1. Vonesa në miratimin nga Kuvendi të projektligjit të KLSH-së;
2. Miratimi i Ligjit në mospërputhje të plotë me standardet INTOSAI;
3. Mos-implementimi në kohë i Projektit të Binjakëzimit IPA 2013.